

## Prioritet kompensimi në natyrë

Botuar ne metropol

**20/06/2011** Flet kreu i AKKP-së, Elvis Çefa: Planveprimi, domosdoshmëri si pasojë e problematikës së çështjeve të pronësisë

Deri tani fondi fizik ka mbi 71 000 ha pyje, mbi 17 000 ha tokë bujqësore e 100 objekte

Kompensimi fizik i ish-pronarëve do të mund të fillojë menjëherë pas përfundimit të një sërë procesesh të tjera, si **njohja dhe kthimi i pronës aty ku është e mundur, verifikimi i titujve të pronësisë, si dhe procesi i legalizimit. Ky proces mund të nisë pas vitit 2018**, pasi qeveria të ketë një pasqyrë të saktë të gjendjes së pronave shtetërore në dispozicion të kompensimit fizik. Por tashmë fondi fizik është pasuruar me mbi 71 000 ha pyje, mbi 17 000 ha tokë bujqësore e 100 objekte. Kreu i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Elvis Çefa, thekson në një intervistë se ky institucion po administron dhe verifikon rregullisht situatën juridike të fondit të kompensimit fizik, i cili do të shërbejë për këtë qëllim. "Duke qenë se procesi i azhurnimit të këtij fondi është një proces dinamik, ai parashikohet të vazhdojë deri në vitin 2018, gjithnjë referuar planveprimin për të cilin po flasim. Për këto arsye edhe procesi i kompensimit fizik të subjekteve të shpronësuar është një proces, i cili referuar ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" do të vazhdojë të trajtohet nga AKKP paralelisht me mënyrat e tjera të parashikuara në ligj, sikundër edhe planveprimi parashikon dhe do të jetë gjithashtu i implementuar në skemën definitive të kompensimit që parashikohet të vihet në zbatim duke filluar nga viti 2013",- thekson zoti Çefa.

1. Ku konsiston planveprimi i miratuar nga qeveria shqiptare për zgjidhjen e çështjes së pronësisë në vendin tonë?

Fillimisht më lejoni të sqarojë faktin se miratimi nga Këshilli i Ministrave i planveprimin për zgjidhjen e problematikës së çështjeve të pronësisë, nuk do të thotë kurrëse se kjo çështje nuk ka pasur deri më sot vëmendjen e duhur nga qeveria shqiptare apo edhe nga institucionet dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, përkundrazi. Zhvillimet në këtë drejtim, në mënyrë të veçantë **nga viti 2006 e deri sot, dëshmojnë që kjo fushë ka qenë dhe është ndër prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare**. Miratimi i këtij planveprimi në fakt është evoluimi në një stad tjetër të vullnetit qeverisës për përcaktimin qartësisht të politikave dhe veprimeve konkrete që do të ndërmerren duke filluar nga sot e më tej për përmbylljen e çështjeve të pronësisë. Ky planveprim vjen në përgjigje të memorandumit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, duke marrë parasysh çështjet e identifikuar në të, e **gjithnjë në funksion të zgjidhjes finale të problematikës së pronave në Shqipëri dhe ishte fryt i një bashkëpunimi ndërmjet disa institucioneve në zbatim të urdhrit përkatës të Kryeministrit**. Planveprimi në esencë konsiston në përcaktimin e një skeme definitive ligjore të kompensimit të subjekteve të shpronësuar, skemë e cila në fakt do t'i shërbejë si një mjet efektiv i brendshëm i shtetit për ekzekutimin e vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit që nga momenti kur ky proces ka filluar. Pra, në fjalë të tjera synohet të përcaktohet një skemë kompensimi e thjeshtë e transparente dhe e përhershme, e cila në fakt **do të rrisë ndjeshëm sigurinë juridike** të këtij procesi **nëpërmjet rivendosjes në vend të një të drejte të mohuar, të drejtës së pronësisë**. Sigurisht që ky është qëllimi final, për arritjen e të cilit do të merren disa masa të tjera institucionale dhe ligjore që nënkupton që deri në momentin që kjo skemë do të finalizohet do të bëhet një punë paraprake shumë e çmuar në drejtim të përgatitjes së infrastrukturës së nevojshme. Konkretisht skema e re për kompensim do të fillojë të operojë në janar të

vitet 2013. Deri në këtë moment do të punohet që shteti shqiptar të ketë një informacion të saktë dhe përfundimtar për numrin e subjekteve që kërkojnë kompensim dhe për rrjedhojë do të ketë një faturë totale financiare për këtë proces. Do të punohet për të ndërtuar një bazë të dhënash të dixhitalizuara në AKKP, e cila në aspektin hartografik do të ndërtohet (programohet) mbi hartat e standardizuara të prodhuara nga një agjenci e veçantë (**Agjencia Kombëtare për Prodhimin e Hartave të Standardizuara**). Me këtë informacion të unifikuar do të punojnë të gjitha institucionet që trajtojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo çështje të pronësisë. Në funksion të një koordinimi dhe ecurie më të mirë të problematikës së pronave në Shqipëri është parashikuar të ngrihet një strukturë e veçantë në Ministrinë e Drejtësisë, e cila do të përgatisë, ndjekë dhe realizojë politikat dhe veprimtaritë që lidhen me hartimin e studimeve në fushën e legjislacionit për të drejtat e pronësisë. Kjo strukturë gjithashtu **do të koordinojë institucionet, si: AKKP, ZRPP, ALUIZNI, DASHPP, KQT, Avokatura e Shtetit dhe do të mbikëqyrë e monitorojë procesin e kompensimit të pronave** dhe implementimin e masave strategjike të propozuara në planveprimin për çështjet e pronave. Pra, tashmë dimensiononi që i jepet kësaj çështjeje tejkalon edhe fushën që mbulon Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave.

2. Pse është i nevojshëm hartimi i këtij planveprimi?

Hartimi i këtij planveprimi në fakt është një domosdoshmëri që vjen si pasojë e evoluimit të situatës dhe çështjeve të pronësisë në Shqipëri. Sikurse e kam thënë edhe herë të tjera, **tashmë sfida e ardhme e shtetit shqiptar është ekzekutimi i titujve të kompensimit të njohur në vite**. Ky vullnet shtetëror shqiptar është në rezonancë edhe me qëndrimin që Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka mbajtur në trajtimin e çështjeve të shtetasve shqiptar. Planveprimi, sikurse e thashë, merr përsipër të sistemojë dhe të rregullojë për sa është e mundur, edhe një sërë problematikash të hasura deri më sot në këtë drejtim. Problematika, që kanë të bëjnë me mungesën e koordinimit ndërinstitutional në qarkullimin e dokumentacionit dhe në ndërveprimin e arkivave të secilit prej tyre, si dhe të proceseve të ndryshme që **prekin pronat siç është legalizimi, verifikimi i titujve të dhënë me ligjin 7501, privatizimi dhe regjistrimi. Kuadri ligjor për pronat paraqitet i fragmentuar dhe ka nevojë të thjeshtohet e të konsolidohet për të përcaktuar procedura të thjeshta dhe transparente kompensimi**. Aktualisht mungon një hartë kombëtare unike e pronësisë, si dhe nuk ka përfunduar procesi i regjistrimit fillestar i pasurive të paluajtshme në të gjithë territorin e vendit, si dhe procesi i legalizimeve për aplikimet e mbetura. AKKP-ja nuk ka bazë elektronike unike të dhënash për vendimet, të cilat në vetvete nuk janë të përditësuara, kryesisht në drejtim të ndryshimeve që mund të kenë pësuar në rrugë gjyqësore. Të gjithë këto elementë të marrë së bashku ndikojnë drejtpërdrejtë në procesin e kompensimit.

3. A do të ketë ndryshim të kritereve për kompensimin financiar të ish-pronarëve dhe si është i parashikuar në planveprimin e qeverisë? Si do të bëhet kompensimi financiar më tej?

Skema e re e kompensimit financiar, e cila mendohet të instalohet në ligj (theksoj se ende është një projekt), parashikohet të funksionojë sipas disa kritereve kryesore dhe shumë të thjeshta:

-Masa e kompensimit do të jetë 100% dhe do të shpërndahet me këste të barabarta derisa të arrihet kompensimi i plotë për çdo pronar.

-subjektet duhet të paraqesin kërkesë për kompensim në AKKP një herë të vetme brenda një afati që do të vendoset në ligj, pra jo çdo vit.

-Kërkesat që pranohen si të plota do të regjistrohen në një bazë elektronike të dhënash në rend kronologjik.

-Kompensimi do të kryhet automatikisht nga vetë shteti (mbështetur në bazën elektronike të të dhënave) dhe dhënia e kompensimit në natyrë do të ketë përparësi në raport me dhënien e kompensimit financiar, në mënyrë që të ulet fatura financiare për shtetin.

Kjo skemë parashikohet të diskutohet gjatë muajve në vazhdim me ish-pronarët dhe grupet e tjera interesi të interesuara.

4. A ka qeveria shqiptare një evidencë të dosjeve të ish-pronarëve shqiptarë që janë në trajtim në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut sa i përket probleme me pronësinë? A është ky planveprim një zgjidhje për të rregulluar çështjet e pronësisë së pari sipas kuadrit ligjor shqiptar, për të ezauruar vetëm në hallkën e fundit të drejtën ndërkombëtare?

Sigurisht, **qeveria e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, që është institucioni me ligj i përcaktuar për të mbrojtur shtetin shqiptar në instancat ndërkombëtare sikurse është GJEDNJ, ka statistika të qarta dhe të plota lidhur me numrin e çështjeve që subjekte të shpronësuar shqiptarë kanë ngritur pranë asaj gjykate.** Në kuadër të çështjeve që kanë si objekt pretendimet e ankuesve shtetas shqiptarë për mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, që lidhen me të drejtat e ish-pronarëve për kthimin apo kompensimin e pronës në zbatim të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave", është konstatuar se cenimi i së drejtës së pronës ndaj individëve ka ardhur si pasojë e pengesave dhe vështirësive për realizimin e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës dhe jo vetëm. Gjykata Evropiane në vendimet e saj për disa raste të përsëritura ka konstatuar se **mosekzekutimi i vendimeve të komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave në kohë, vendime të cilat i konsideron si gati gjyqësore, cenon të drejtën e ankuesve për proces të rregullt ligjor.** Gjykata ka vlerësuar gjithashtu se sistemi juridik vendas nuk ofron mjete ligjore efektive ankimi për adresimin e mosekzekutimit të vendimeve të formës së prerë. Pra, për t'iu përgjigjur më konkretisht pyetjes tuaj, sigurisht që me anë të këtij planveprimi synohet ndër të tjera edhe ngritja brenda sistemit juridik të brendshëm shqiptar të një mjeti efektiv për realizimin e së drejtës së ekzekutimit të një vendimi të ish-KKKP për kompensim.

5. Deri ku ka arritur puna për përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme për të zbatuar këtë planveprim dhe kur do të bëhet konsultimi me grupet e interesit? Cila është pritshmëria juaj nga këto diskutime me palët e interesuara?

Duke qenë se Vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e planveprimit ka pak ditë që ka hyrë në fuqi, pritet që periudhën në vazhdim të fillojë pa humbur kohë implementimi i tij. Afatet janë të mirëstudiuara nga grupi teknik i punës i ngritur për këtë qëllim nga Kryeministri. AKKP është vetëm një nga aktorët në këtë planveprim dhe vënia në jetë e planveprimit nuk i përket vetëm asaj, por edhe Ministrisë së Drejtësisë, Avokaturës së Shtetit etj. Pra, çdo veprim që do të ndërmerret në këtë drejtim do të jetë i mirëkoordinuar. Si fillim mendoj që, ashtu sikurse vetë planveprimi ka parashikuar, **një nga hapat e parë që do të ndërmerren do të jetë pikërisht konsultimi me grupet e interesit që nuk do të thotë të jetë domosdoshmërisht shoqata e ish-pronarëve.**

6. Kompensimi fizik është një tjetër e drejtë që ish-pronarët presin prej shumë vitesh ta rifitojnë në favor të tyre. Kur mund të nisë ky proces dhe

kur mund të përfundojë? A ka troje të lira për këtë proces dhe sa mund të jetë me përafërsi kjo shifër?

AKKP si agjenci, e cila zbaton politikën qeveritare në njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave, është shumë e ndjeshme ndër të tjera, edhe në drejtim të procesit të kompensimit fizik të subjekteve të shpronësuara. Në këtë kontekst AKKP po administron dhe verifikon rregullisht situatën juridike të fondit të kompensimit fizik, i cili do të shërbejë për këtë qëllim. Identifikimi i pasurive të paluajtshme, të cilat do të jenë potencialisht pjesë e këtij fondi është një proces i vështirë dhe i ndërvarur nga disa procese të tjera dhe për këtë arsye kërkon kohë. Janë miratuar tashmë disa vendime qeverie që kanë vepruar në drejtim të pasurimit sistematik të këtij fondi. **Deri tani, qeveria ka kaluar në fondin e kompensimit fizik mbi 71 000 ha pyje, mbi 17 000 ha tokë bujqësore dhe mbi 100 objekte.** Por, që të fillojë zbatimi masiv i kompensimit fizik, do të duhet të përfundonte paraprakisht procesi i njohjes dhe kthimit të pronës aty ku është e mundur, të përfundonte procesi i verifikimit të titujve të pronësisë, si dhe procesi i legalizimit, kjo në mënyrë që të kemi një pasqyrë të saktë të gjendjes së pronave shtetërore, të cilat do të jenë në dispozicion të kompensimit fizik. Në vijim të asaj që parashirova më sipër, efektet e ligjit "Për verifikimin e titujve të pronësisë" dhe përfundimi i punës nga komisionet përkatëse pranë prefektëve të qarqeve, do të ndikojë gjithashtu edhe në pasurimin e fondit të kompensimit fizik me toka, të cilat janë përfituar në mënyrë të kundërligjshme nga zbatimi jo i drejtë i ligjit nr. 7501. Pra, duke qenë se procesi i azhurnimit të këtij fondi është një proces dinamik, ai parashikohet të vazhdojë deri në vitin 2018, gjithnjë referuar planveprimet për të cilin po flasim. Për këto arsye edhe procesi i kompensimit fizik të subjekteve të shpronësuar është një proces, i cili, referuar ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", do të vazhdojë të trajtohet nga AKKP paralelisht me mënyrat e tjera të parashikuara në ligj, sikundër edhe planveprimi parashikon dhe do të jetë gjithashtu i implementuar në skemën definitive të kompensimit që parashikohet të vihet në zbatim duke filluar nga viti 2013.